



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 23 dhjetor 2013
Nr.ref.:RK531/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI151/13

Parashtrues

Sitkije Morina

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 176/2012,
të 18 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Sitkije Morina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja), e përfaqësuar nga z. Sahit Bibaj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 176/2012, i 18 prillit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtrueses më 24 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 176/2012, të 18 prillit 2013. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme, në pjesën që ka të bëjë me kompensim për dëmin material, vendosi të vërtetojë aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, me të cilin kompania e sigurimit ishte e obliguar t'i paguajë parashtrueses të kërkesës kompensimin në vlerë prej 1,500.00 € plus kamatën e caktuar. Në pjesën që ka të bëjë me kompensim për dëmin jomaterial, përkatësisht shpenzimet e rehabilitimit dhe kamata e caktuar, ajo vendosi t'ia kthejë rastin për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Baza ligjore

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 shtator 2013, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 shtator 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Kolegji shqyrtues është i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 17 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 23 tetor 2013, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi autorizimin në Gjykatë.
9. Më 28 tetor 2013, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 3 qershor 2005, parashtruesja e kërkesës, si bashkudhëtare në veturë, ishte viktimë e një aksidenti të trafikut, duke pësuar lëndime trupore.

12. Më 2 maj 2007, parashtruesja paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Rahovec kundër kompanisë së sigurimit për kompensimin e dëmit.
13. Më 17 tetor 2007, Gjykata Komunale në Rahovec, me Aktgjykimin e saj, C. Nr. 129/07, e aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës.
14. Si pasojë e ankesës së paraqitur nga kompania e sigurimit, më 8 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, në Aktgjykimin e saj, Ac. Nr. 82/08, e vërtetoi pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Rahovec, C. Nr. 129/07, të 17 tetorit 2007, në lidhje me kompensimin e dëmit, ndërsa pjesa që i referohej shëmtimit trupor dhe rehabilitimit ishte kthyer për rigjykim.
15. Si rezultat i kësaj, më 27 gusht 2009, Gjykata Komunale në Rahovec, me Aktgjykimin e saj, C. Nr. 188/09, e aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës dhe e obligoi kompaninë e sigurimit që t'i paguajë parashtrueses shumën për kompensim në vlerë prej 1,500.00 € për shëmtim trupor dhe 1,200.00 € për rehabilitim fizioterapeutik-klimatik, duke filluar prej 2 majit 2007 deri në pagesën përfundimtare të borxhit, duke përfshirë shpenzimet procedurale në shumë prej 1,050.00 €.
16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Rahovec, C. Nr. 188/09, të 27 gushtit 2009, kompania e sigurimit ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
17. Më 5 mars 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, në Aktgjykimin e saj, Ac. Nr. 64/2010, e refuzoi ankesën e kompanisë së sigurimit, si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Rahovec, C. Nr. 188/09, të 27 gushtit 2009.
18. Më 19 prill 2012, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. Nr. 64/2010, të 5 marsit 2012, kompania e sigurimit parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme.
19. Në revizionin e dorëzuar Gjykatës Supreme, kompania e sigurimit pretendoi si në vijim:

[...]

"Miratimi i kërkesëpadisë për rehabilitim mjekësor është i pabazuar në prova dhe fakte dhe nuk dëshmohet me asnjë provë se paditësi ka qenë në rehabilitim dhe tretman fizioterapeutik."

[...]

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë vendos në kundërshtim me dispozitat ligjore edhe për sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës si dhe mbi kamatën prej 20% e cila është kamatë e palejuar dhe në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore. Kjo kamatë është e papranueshme në praktikën gjyqësore dhe e njëjta krijon elementin e fitimit të pabazë, ngase shuma e gjykuar është më e vogël në krahasim me kamatën e gjykuar, e cila nuk dihet se a është mujore apo vjetore apo është kamatë e cila do të llogaritet vetëm në momentin e kompenzimit."

20. Më 18 prill 2013, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, Rev. Nr. 176/2012, vendosi:

I. Të refuzohet si i pabazuar revizioni i paraqitur nga kompania e sigurimit, për pjesën që ka të bëjë me dëmin jomaterial në emër të shëmtimit trupor në shumën prej 1.500.00 €, duke përfshirë kamatën e caktuar, duke filluar prej 17 tetorit 2007, nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë deri në pagesën definitive; dhe

II. Të pranohet si i bazuar revizioni dhe të priset Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Rahovec, C. nr. 188/09, të 27 gushtit 2009 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 64/2010, i 5 marsit 2012, në pjesën që ka të bëjë me vendimin për dëmin material në emër të rehabilitimit, kamatës për dëmin jomaterial si dhe të shpenzimeve të procedurës. Për këtë pjesë, Gjykata Supreme vendosi që lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

21. Duke iu referuar pjesës së vendimit për refuzimin e revizionit lidhur me dëmin jomaterial, Gjykata Supreme gjeti se:

[...]

“Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke gjetur se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të procedurës kontestimore dhe për faktet relevante përmban arsye të mjaftueshme, prandaj ankesën e së paditurës e ka refuzuar si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.”

[...]

22. Sa i përket pjesës së vendimit për pranimin e revizionit në lidhje me dëmin material, të paraqitur nga kompania e sigurimit, Gjykata Supreme konstatoi se:

[...]

“Gjykata e shkallës së parë, në pjesën e dispozitivit që ka të bëjë me dëmin material, pra në emër të rehabilitimit fizioterapeutik-klimatik, në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale, sepse ka mbetur pa u vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të plotë, kur në emër të rehabilitimit fizioterapeutik ka caktuar shumën prej 1.120 €, dhe kjo Gjykatë tani për tani nuk mund ta pranojë një përfundim të tillë të gjykatave të instancës më të ulët.

Sipas konstatimit të ekspertit mjekësor [...], paditësja kishte nevojë për shërim fizioterapeutik-klimatik, por gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar faktin nëse paditësja ka qenë në shërim fizioterapeutik -klimatik për të vërtetuar se paditësja ka pësuar dëme materiale lidhur me rehabilitimin.

Prandaj, për të vërtetuar këto fakte, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në riprocedurë të mënjanojë të metat e përmendura ashtu që lidhur me shpenzimet e shërimit klimatik të urdhërojë paditësen që t'i sjellë gjykatës prova nga institucioni përkatës, që kanë të bëjnë me terapinë

fizikale për të konstatuar shumën e paguar për këtë periudhë kohore nëse paditësja ka qenë në institucion rehabilitues duhet të provojë se ka pasur dëme materiale lidhur me rehabilitimin dhe pas vërtetimit të këtyre rrethanave si dhe provave të tjera eventuale, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Poashtu me rastin e caktimit të kamatës në emër të dëmit jomaterial për shëmtim trupor dhe rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik, gjykata e shkallës së parë ka caktuar kamatën prej 20% duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë pa dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me caktimin e lartësisë së kamatës si dhe datën e llogaritjes së kamatës për dëmin jomaterial.

Duke pasur parasysh se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur në pjesën që ka të bëjë me dëmin material, u deshtë që të priset edhe vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës.”

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesja pretendon shkeljen e nenit 24.2 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe dispozitat e Procedurës Kontestimore.
24. Parashtruesja pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përkatësisht në pjesën në të cilën vendosi ta pranojë revizionin e kompanisë së sigurimit dhe t’ia kthejë rastin gjykatës së shkallës së parë për rigjykim: [...] *“i jan shkelë të drejtat ne gjykim te drejtë dhe te pa anshëm, ngase palët në procedurë nuk jan trajtuar barabarësisht, dhe se gjykata ma e lartë nuk kan shqyrtuar provat dhe faktet qe ka ofruar paditësja, përgjigjen ne revizion, ngase sipas Ligjit ne fuqi [...]”*
25. Parashtruesja më tutje pretendon se [...]” në radhë të parë, revizioni është dashtë të hudhet si i palejuar, ne kuptim te nenit 211.1, te LPC-së [Ligji i Procedurës Kontestimore], sepse revizioni është parashtruar ndaj aktgjykimit të gjykates se shkallës së parë e jo ndaj aktgjykimit te shkallës se dytë siq parashihet me ligj, dhe ne rradhe te dyte revizioni është parashtruar për objektin e kontestit per objektin e kontestit qe nuk kalon vleren prej 3000€, qka është ne kundërshtim me nenin 211.2 të LPC-së. Dhe sipas ketij kriteri te dytë revizioni është dashtë të hudhet si i pa lejuar.“
26. Parashtruesja përfundon, duke kërkuar nga Gjykata:

“Te konstaton se me aktgjykimin përfundimtar te Gjykatës Supreme te Kosovës Rev. nr. 176/2012, te dt. 18.04.2013, me al. II, te Dispozitivit te aktgjykimit ka shkelje të kushtetutës dhe të ligjit ne aplikim, per gjykim te drejtë dhe te pa anshëm, ne pajtim me kushtetutën dhe ligjin.

Aktgjykimi i Gjykates Supreme te Kosovës, Rev. nr. 176/2012, i dt. 18.04.2013, alineja II e dispozitivit te shfuqizohet dhe revizioni i te paditurës të hudhet si i pa lejuar me ligj”.

27. Sa i përket pretendimit të parashtrueses dhe kërkesës drejtuar Gjykatës, pretendimet e parashtrueses, ndahen si në vijim:

A. Pretendimi në lidhje me vendimin e Gjykatës Supreme për ta kthyer rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë; dhe

B. Pretendimi në lidhje me pranueshmërinë e revizionit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

Sa i përket pretendimit të parë të parashtrueses së kërkesës lidhur me vendimin e Gjykatës Supreme për ta kthyer rastin për rigjykim në instancën e shkallës së parë

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, i cili përcakton se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Neni 47 (2) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, gjithashtu parasheh:

“Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Në rastin konkret, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, Rev. Nr. 176/2012, e pranoi revizionin e kompanisë së sigurimit për pjesën që ka të bëjë me dëmin material, me të cilin vendosi t'i prishë aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Rahovec, C. nr. 188/09, të 27 gushtit 2009, dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 64/2010, të 5 marsit 2012 dhe ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

32. Prandaj, kërkesa është e parakohshme, sepse rasti i parashtrueses që ka të bëjë me shpenzimet për rehabilitim, kamatën dhe shpenzimet e procedurës në lidhje me dëmin material është ende në pritje për t'u zgjidhur në procedurën e rregullt gjyqësore.

33. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e kompetencave ligjore dhe është obligim i tyre kushtetues dhe prerogativë për t'i interpretuar çështjet e fakteve dhe ligjit, të cilat janë relevante për rastet e ngritura para tyre.

34. Arsyetimi mbi rregullin e shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar

shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih rastin KI41/09, parashtrues i kërkesës AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, Aktvendimi për papranueshmëri, i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, Selmouni kundër Francës, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).

35. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohen shkeljet kushtetuese apo, nëse ka, të korrigojohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. (Shih rastin KI07/09, parashtruesit Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Aktvendimi për papranueshmëri, i 19 majit 2010).
36. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të vlerësojë ndonjë shkelje të pretenduar kushtetuese, pa iu dhënë mundësia gjykatave të rregullta që t'i përfundojnë procedurat në pritje dhe t'i korrigojnë shkeljet e pretenduara.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit për papranueshmërinë e revizionit në Gjykatën Supreme

37. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme do të duhej ta kishte hedhur poshtë revizionin e parashtruar nga kompania e sigurimit, si të palejueshëm. Në këtë drejtim, ajo pretendon se “[...] në radhë të parë, revizioni është dashtë të hudhet si i palejuar, ne kuptim të nenit 211.1, të LPC-së [Ligji i Procedurës Kontestimore], sepse revizioni është parashtruar ndaj aktgjykimit të gjyqësor se shkallës së parë e jo ndaj aktgjykimit të shkallës së dytë siq parashihet me ligj, dhe në rradhë të dytë revizioni është parashtruar për objektin e kontestit për objektin e kontestit që nuk kalon vlerën prej 3000€, qka është në kundërshtim me nenin 211.2 të LPC-së. Dhe sipas këtij kriteri të dytë revizioni është dashtë të hudhet si i palejuar.”
38. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar.”
39. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
40. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese përsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu rastin

KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Për më tepër, Gjykata Supreme, në aktgjykimin për pjesën që ka të bëjë me dëmin jomaterial, e refuzoi revizionin e parashtruar nga kompania e sigurimit dhe e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës më të ulët. Për këtë pjesë, Gjykata Supreme e obligoi kompaninë e sigurimit t'i paguajë parashtrueses së kërkesës shumën prej 1,500.00 € plus kamatën e caktuar, kjo duke qenë vendimi në dobi të parashtrueses. Në anën tjetër, për pjesën që ka të bëjë me dëmin material, përkatësisht shpenzimet për rehabilitim dhe kamatën e caktuar, Gjykata Supreme vendosi që të kthejë rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
42. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave kushtetuese, përderisa procedura që ka të bëjë me dëmin material ende është në pritje në Gjykatë, dhe për më tepër, vendimi i Gjykatës Supreme për të vërtetuar aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në lidhje me dëmin jomaterial, është në dobi të saj.
43. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49, paragrafin 2, të Ligjit dhe rregullin 36.(1) a) dhe 36.(2) c) të Rregullores së punës, më 23 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani